



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA

KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS / OPŠTINA KOSOVO-POLJE
MUNICIPALITY OF FUSHË-KOSOVË, KOSOVO POLJE



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS - OPŠTINA KOSOVO POLJE DREJTORIA E ADMINISTRATËS - DIREKCIJA ZA ADMINISTRACIJË
Mr./q./Dr./st. 142
Data/Date 21.10.2020
KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS - OPŠTINA KOSOVO POLJE

Ekstrakt nga procesverbali i mbledhjes së shtatë - VII-të, të jashtëzakonshme të Kuvendit të Komunës, e mbajtur me datën 19.08.2020, ora 10:00h, në Sallën e Kuvendit të Komunës.

Prezentë në mbledhje ishin anëtarët e Kuvendit të Komunës: Vjollca Konjusha - Kryesuese e Kuvendit të Komunës, Remzi Shala, Ilir Hasani, Arjeta Jashari, Mirvete Gërguri, Jetmir Berisha, Albert Jasharaj, Miranda Shabani, Sabit Bullatovci, Sabri Rexhepi, Ali Zogjani, Durim Hajra, Doruntina Jashari, Eglantina Azemi, Aida Alimi, Arjana Zogjani, Migjen Kolshi, Driton Ademi, Ali Ismaili, Driton Hasolli, Mehdi Lahu, Shaban Ademi, Mënsur Grajqevci, Hysni Hasani, Suhat Ademi dhe Ljubisa Qirkoviq.

Mungon: Naser Graiçevci.

Kryetari i Komunës dhe Drejtorët e Drejtorive të Komunës: Fadil Krasniqi - Nënkryetar i Komunës, Ramadan Jashanica - Drejtor i Financave e Buxhetit, Islam Shabani - Drejtor i Arsimit dhe Ekrem Berjani - Drejtor i Zhvillimit Ekonomik.

Kryesuesja e Kuvendit të Komunës përshëndeti të pranishmit në mbledhje, pas verifikimit të prezencës së anëtarëve të Kuvendit të Komunës, konstatoi se ekziston kuorumi për mbajtjen e mbledhjes dhe prezantoi këtë:

REND DITE

1. Propozim për ridestinimin dhe ndarjen e mjeteve financiare nga buxheti i planifikuar komunal për vitin 2020.

Kryesuesja e Kuvendit të Komunës, sqaroi se për shqyrtim në këtë mbledhje të jashtëzakonshme e kemi pikën e vetme të rendit të ditës 'Propozimin për ridestinimin dhe ndarjen e mjeteve financiare nga buxheti i planifikuar komunal për vitin 2020'. Hap diskutimin.

Migjen Kolshi: Përshëndes të pranishmit në mbledhje. Kërkoj që ne si Kuvend i Komunës ta mbajmë një minutë heshtje, për veteranin e shëndetësisë z. Ali Osmani i cili ka dhënë kontribut të çmuar që nga vitet e gjashtëdhjeta, e sidomos në vitet e nëntëdhjeta ka dhënë kontribut të jashtëzakonshëm për popullatën e komunës tonë, në kohën më të vështirë, mua personalisht ma ka shpëtuar jetën ky profesionist dhe humanist i madh, që ne duhet ta vlerësojmë lartë kontributin e tij.

Kryesuesja e Kuvendit të Komunës ftoi anëtarët e Kuvendit të Komunës dhe të pranishmit e tjerë në këtë mbledhje, që ta mbajmë një minutë heshtje për nderimin e veprës së z. Ali Osmani, i cili ka dhënë kontribut të çmuar në shëndetësi në vitet e nëntëdhjeta.

Pas sqarimeve, Kryesuesja e Kuvendit të Komunës e qiti në votim për aprovim rendin e ditës.

U votua unanimisht nga të pranishmit, gjithsej njëzet e gjashtë anëtarë të pranishëm.

Në bazë të votimit, Kryesuesja e Kuvendit të Komunës konstatoi se Kuvendi i Komunës, me unanimitet të votave e aprovoi rendin e ditës.

Pika e parë (1) - Propozim për ridestininimin dhe ndarjen e mjeteve financiare nga buxheti i planifikuar komunal për vitin 2020.

Kryesuesja e Kuvendit të Komunës: E kemi për shqyrtim 'Propozimin për ridestininimin dhe ndarjen e mjeteve financiare nga buxheti i planifikuar komunal për vitin 2020', sipas shkresës së ministrisë së Financave Nr. 01/1957, të datës 10.08.2020, ftoi Drejtorin e Financave dhe Buxhetit që të na jap sqarime.

Drejtori për Financa dhe Buxhet: Përshëndes të pranishmit në mbledhje. Këto mjete financiare janë nga fondi rezervë për rritjen e pagave të sektorit publik, mirëpo meqë ligji për paga është shpallur jokushtetues nga Gjykata Kushtetuese, atëherë Ministria e Financave ka vendosur për shpenzimin e tyre dhe ka dërguar shkresën me Nr. 01/1957 me datën 10.08.2020, që këto mjete financiare mund të shfrytëzohen nga Komunitet e Republikës së Kosovës për shëndetësi, ekonomi dhe nevojat tjera komunale në kohën e pandemisë Kovid - 19, ju tani para vetës e keni tabelën e shpërndarjes së këtyre mjeteve financiare për shpenzim në shëndetësi si vijon: për shërbime të ndryshme shëndetësore - teste shuma e mjeteve financiare prej: 80,000.00€, për furnizime mjekësore shuma e mjeteve financiare prej: 80,000.00€, për pako ushqimore për nevojat e qytetarëve shuma e mjeteve financiare prej: 35,000.00€, për pako hixhenike për nevojat e qytetarëve shuma e mjeteve financiare prej: 15,000.00€ dhe për ndihmë Organizatave Jo Qeveritare shuma e mjeteve financiare prej: 10,000.00€, në Drejtorinë për Shërbime Publike për dezinfektimin e rrugëve, ndërtesave dhe shkollave shuma e mjeteve financiare prej: 80,000.00€, në Drejtorinë e Zhvillimit Ekonomik shuma e mjeteve financiare prej: 400,000.00€, me destinim për ndihmë ekonomike sektorit privat dhe në Drejtorinë për Kulturë, Rini dhe Sport shuma e mjeteve financiare prej: 48,595.00€, gjithsej shuma e mjeteve financiare të planifikuar për shpenzim është 748,595.00€.

Shaban Ademi: Përshëndes të pranishmit në mbledhje. Këtu ne e kemi të planifikuar për shpenzim shumën e mjeteve financiare prej: 748,595.00€, të paraparë për shpenzim në shëndetësi, në ekonomi për bizneset e Komunës së Fushë-Kosovës dhe në kulturë, rini e sport, janë propozuar për shpenzim 80,000.00€ për shërbime shëndetësore - teste për qytetarët e komunës falas, ndërsa edhe 80,000.00€ tjera për furnizime mjekësore, po ashtu 35,000.00€ për pako ushqimore dhe 10,000.00€ tjera për pako hixhenike për qytetarët në nevojë. Shuma prej: 80,000.00€ për shërbime publike dhe shuma prej: 400,000.00€ për biznese, 45,000.00€ tjera për sport, unë këtu e kam një vërejtje shumë serioze, të nderuarë përfaqësues të Ekzekutivit të Komunës, ku është arsimi këtu, mësimi në shkollë është ndërprerë me 11 mars, në fillim Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë dhe Drejtoria Komunale e Arsimit e kanë propozuar mësimin online, disa mësues dhe nxënës nuk kanë patur mjete elektronike të punës - llap-topë, por janë gjindur disa me platforma sociale është zhvilluar procesi mësimorë, në fillim ka patur vështirësi, por më vonë jemi mësuar me këtë mënyrë të komunikimit me nxënës, tani pritet që në shtator të fillon mësimi në shkollat tona, andaj nevojiten mjete financiare shtesë për arsim, për dezinfektimin e shkollave, furnizimin me maska për mësues dhe nxënës, furnizimin me mjete të punës për nxënës të familjeve me gjendje të rëndë sociale, ju si Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Kosovës votat i keni dhe mund ta kaloni propozimin në fjalë, mirëpo unë propozoi, që të bëhen këto ndryshime: nga pakot ushqimore të mirret shuma e mjeteve financiare prej: 5,000.00€, nga pakot hixhenike shuma e mjeteve financiare prej 3,000.00€, nga dezinfektimi i rrugëve dhe ndërtesave shuma e mjeteve financiare prej: 10,000.00€ dhe nga ndihma për bizneset të mirret shuma e mjeteve financiare prej:

50,000.00€, që kështu të arrihet një shumë prej: 68,000.00€ dhe kjo shumë e mjeteve financiare për ndahet për arsimin, kjo punë do të iu bënte nderë të gjithëve, sepse i kemi gjashtëmbëdhjetë objekte shkollore që duhet të përgatiten për procesin arsimorë dhe ato tani janë keq, andaj duhet ta përkrahim arsimin në këtë kohë të vështirë për të gjithë, mësuesit, prindërit dhe nxënësit, për një fillim të mbarë të vitit të ri shkollor.

Drejtori për Financa dhe Buxhet: Unë dua të sqaroj para juve këtu, se arsimi i ka në dispozicion për shpërndarje shumë e mjeteve financiare prej: 240,000.00€, kjo është arsyeja që nuk është specifikuar ndonjë shumë e caktuar për arsim, sepse i kemi mjetet financiare të planifikuara, këto janë mjete financiare shtesë nga fondi rezervë i pagave.

Shaban Ademi: Ne e kemi Drejtorin e Arsimit këtu unë e di që shkollat janë në gjendje të rëndë teknike, andaj propozoi që të ndahet shuma e propozuar për arsimin.

Migjen Kolshi: Ne e kemi propozimin e Ekzekutivit të Komunës para vetës për shqyrtim, i cili kalon, por ne nuk pajtohemi me shpërndarjen e propozuar, kemi vërejtje me shumë e mjeteve financiare prej: 80,000.00€ mund të bëhen vetëm katër mijë teste, njerëzit kanë më shumë nevojë për furnizimin me barna të ndryshme falas nga shteti, sigurisht se në fillim testohen rreth një mijë zyrtarë të administratës së komunës, arsimi të shëndetësisë dhe mbesin vetëm tremijë teste për qytetarë, shtrohet pyetja cilët qytetarë do të testohen. Ndihma për qytetarë dhe ndihmat për Organizatat Jo Qeveritare po shfrytëzohet politikisht nga ju. Më herët është shfrytëzuar shuma e mjeteve financiare prej 119,000.00€ për dezinfektim, por virusi prap është shpërndarë, ata që kanë keqpërdorë duhet t'i brenë ndërgjegjëja e tyre. Ndihma ekonomike për sektorin privat nuk e përmirëson ekonominë, sepse bizneset kanë pësuar humbje të mëdha me mijëra euro deri në 200,000.00€ dhe ndihma e komunës prej qindra eurove nuk ndikon në përmirësimin e gjendjes së tyre afariste, këtu efekti në ekonomi është i vogël, sepse bizneset shumica janë biznese familjare, nuk janë biznese të mëdha. Unë pajtohem që të ndihmohen klubet sportive, sepse kanë nevojë për ndihmë të komunës në këtë kohë të vështirë, unë mendoi se shuma e mjeteve financiare për kulturë, rini dhe sport duhet të rritet.

Driton Ademi: Përshëndes të pranishmit në mbledhje. Materiali për shqyrtim duhet ta ketë një lloj konsolidimi në përmbajtjen e tij, sepse Asambleja Komunale është organi më i lartë i komunës dhe nuk duhet të dorëzohen për shqyrtim propozime të pa kompletuara, duhet të deshifrohen një nga një nën pikat në rendin e ditës. Dokumentacioni për shqyrtim është opcional, ne e kemi shkresën e Ministres së Financave znj. Hykmete Bajrami meqë nuk ka kaluar ligji për paga. Nga kjo shumë së pari duhet të shikohen për pagesë obligimet kontigjente të komunës, siç janë edhe pagesat në arsim për arsimtarët për realizimin e të drejtave të tyre nga kontrata kolektive. Ligji për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësisë e sanksionon këtë në nenin 15 dhe nenin 30, se kategoritë ekonomike mund të shpenzojnë 5%, 15% dhe 25% të buxhetit, pa problem në këtë kohë, sipas kërkesave për menaxhimin e situatës emergjente nga Ekzekutivi i Komunës. Rregullat e Ministrisë së Financave i parashohin këto situata në planifikimin vjetor, kjo mënyrë e shpenzimit është e paligjshme, disa shpenzime të propozuara këtu janë të panevojshme dhe në kundërshtim me planifikimin e buxhetit. Dezinfektimi i rrugëve nuk e ka dhënë efektin e paraparë, dezinfektimi i shkollave nuk është bërë, po ashtu këtë vitë nuk është bërë as dezinfektimi, janë shpërndarë shumë mushkonja të cilat edhe mund të përhapin sëmundje infektive te njerëzit. Ndihma ekonomike për bizneset është e pa pranueshme, ndihmat për sport në këtë kohë duhet të hiqen, ato duhet të planifikohen në buxhetin e rregulltë.

Durim Hajra: Përshëndes të pranishmit në mbledhje. Ndarja e buxhetit të komunës, duhet të bëhet për sektorët e prekur rëndë nga pandemia dhe që kanë nevojë për ndihmë në këtë kohë, siç është shëndetësia dhe arsimi. Për shpenzimet e ndara nga Kuvendi i Komunës për luftimin e pandemisë në mbledhjen e muajit mars 2020, ne kërkojmë që ta kemi një raport financiarë të detajizuar me shkrim, sepse është ndarë shuma e mjeteve financiare prej 404,000.00€, të cilat janë shpenzuar për pesë dhjetë ditë, tani ende jemi në pandemi dhe nevoja për ndihmë vazhdon. Situata emërgjente dhe pandemike nuk duhet të menaxhohet me vendime 'ad hoc', hapi i fundit duhet të jetë ndihma për sektorin privat dhe sportin, së pari duhet të plotësohen nevojat në shëndetësi dhe arsim. Ekonomia dhe sektori privat duhet të përkrahen nga niveli qendror. Ne jemi komuna e dytë në nivel vendi që e kemi ndarë shumën më të madhe financiare për menaxhimin e pandemisë, pas kryeqytetit Prishtinës. Shuma për pako ushqimore dhe pako hixhenike mendoj se është e nevojshme, stafi shëndetësorë duhet të testohet, sepse është në vijën e parë të ballafaqimit me virusin Kovid - 19, duhet të jetë i përgatitur për t'i shërbyerë qytetarët dhe pacientët në nevojë, pastaj punëtorët e administratës dhe qytetarët me gjendje të rëndë ekonomike dhe sociale, unë mendoj se shuma e mjeteve financiare prej: 80,000.00€ për teste është e mjaftueshme. Furnizimet mjekësore për mjekë dhe infermerë duhet të jenë cilësore, neve këtu në këtë vitë që po ballafaqohemi me pandeminë si gjithë bota, asnjëherë Drejtori i Drejtorisë për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale nuk na ka sqaruar, për nevojat e institucioneve shëndetësore të nivelit lokal. Si përfundim, mjetet financiare të ndara kanë qenë të mjaftueshme dhe në atë kohë ka patur shumë pak raste me Kovid - 19 dhe janë shpenzuar të gjitha mjetet financiare, këtu ka patur një keqëmenaxhim të mjeteve financiare dhe shfrytëzim jo racional të tyre.

Suhut Ademi: Përshëndes të pranishmit në mbledhje. Gjendja e komuniteteve romë, ashkalinj dhe egjiptian është e rëndë, andaj komunitetet tona duhet të përkrahen sepse kanë nevojë për ndihmë, janë ndarë pako ushqimore dhe pako hixhenike në vlerë prej 20€, janë ndarë edhe maska mbrojtëse, por ne kërkojmë që të ndahet një buxhet i veçantë për plotësimin e nevojave të qytetarëve në lagjet tona.

Aida Alimi: Përshëndes të pranishmit në mbledhje. Kjo shumë e planifikuar për shpenzim e mjeteve financiare prej: 748,595.00€, duhet të mirë menaxhohet në interesin e përgjithshëm të qytetarëve të Komunës së Fushë-Kosovës. Po ashtu është fakt i njohur, se komuna jonë e ka patur një buxhet të madhë për menaxhimin e pandemisë në krahasim me komunat tjera të Kosovës, shumë njerëz janë ankuar se nuk u është ofruar ndihmë nga komuna, kur ata kanë patur nevojë. Ndihma ekonomike për bizneset duhet të ndahet në mënyrë të barabartë, duhet të përkrahen bizneset e vogla dhe bizneset që udhëhiqen nga gratë, pa anime partiake. Duhet të jenë të ditura për opinionin paraprakisht kriteret për ndarjen e ndihmës ekonomike për bizneset.

Remzi Shala: Përshëndes të pranishmit në mbledhje. Propozimi për ridestininimin e mjeteve financiare në shumë prej: 748,595.00€, u sqarua nga Drejtori për Financa dhe Buxhet se vjen si pasojë e jo kushtetues të ligjit për paga nga Gjykata Kushtetuese dhe këto mjete financiare shtesë duhet të shpërndahen për shëndetësinë dhe ekonominë e komunës. Kjo shumë është e mirë se ardhur të shpenzohet në shëndetësi, sepse edhe në fillim të pandemisë unë e kam theksuar, se Komuna e Fushë-Kosovës është shumë specifike për arsye të migrimeve të popullsisë nga vise të ndryshme shqiptare, në fillim kemi kaluar mirë, por edhe pas hapjes numri i rasteve të infeksioneve është shtuar, por menaxhimi ka qenë i mirë nga qendra jonë shëndetësore, për aq sa i takon shëndetësisë primare të merret me trajtimin e pacientëve të prekur nga sëmundja ngjitëse Kovid -

19. Tani jemi në pragë të muajit shtator kur fillon mësimi dhe stina e vjeshtës ku përveç virusit korona vjen edhe gripi sezonal, adnaj duhet të punojmë në ndërmarrjen e masave parandaluese për menaxhimin e situatës pandemike. Unë pajtohem që të gjindet një mundësi për përkrahjen e arsimit, sepse pandemia nuk do të përfundon as në muajin shtator, as në muajin dhjetor, por së paku do të zgjat edhe gjashtë muaj apo një vitë. Edhe shumat e propozuar për ndihma ekonomike e ka arsyeshmërinë e vetë, sepse bizneset kanë pësuarë humbje, gjinden në vështirësi të operimit ekonomik. Në arsim duhet të plotësohen kushtet për fillimin e vitit të ri shkollorë, në shëndetësi Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare duhet të përgatitet për realizimin e testeve serologjike për qytetarët e komunës, duhet të blihet aparatura e cila nuk është e shtrenjtë. Ne pajtohemi me shpërndarjen e Ekzekutivit të Komunës, por kërkojmë që brenda mundësive financiare t'i jepet prioritet arsimit dhe shëndetësisë.

Ali Ismaili: Përsëritet të pranishmit në mbledhje. Unë nuk dua të përsërisë temat dhe çështjet që u ngritën nga kolegët lidhur me shpenzimin e këtyre mjeteve financiare paraprakisht. Ajo që e theksoi kolegu z. Driton Ademi qëndron plotësisht, ne si Asamble e Komunës jemi organi më i lartë dhe duhet ta kemi një trajtim më serioz nga Ekzekutivi i Komunës, propozimet duhet të jenë të qarta dhe të kenë mbështetje në legjislacionin në fuqi. Trajtimi i arsimit në vendin tonë ka dështuar duke filluar nga niveli qendror, ne si komunë i kemi dhjetë mijë nxënës dhe me buxhet jemi komunë e vogël, për arsye të regjistrimit zyrtar të popullsisë, sipas të cilit ndahet buxheti nga shteti. Tani për tani shkollat tona janë të pa përgatitura për fillimin e vitit të ri shkollorë, shkollat duhet të dezinfektohen të sigurohen maskat për mësues dhe nxënës, nëse kalohet në mësimin online të jemi të përgatitur, nxënësit nga familjet me gjendje të rëndë ekonomike, duhet të ndihmohen nga shteti dhe komuna me mjete elektronike të punës, në mënyrë që ta vijnë në mësimin. Ne nëse kemi mirëkuptim dhe bashkëpunim edhe mund t'i bartim për shpenzim mjetet financiare nga një kod ekonomik në një kod tjetër ekonomik, aty ku nevojat janë më të mëdha tani në kohën e pandemisë. Ne edhe mund ta ndihmojmë një biznes, të themi një ëmbeltore me 500,00€, por funksionimi i çerdheve të fëmijëve ka dështuar, këtu duhet t'i marrim parasysh tri elemente, ndihmën për ekonominë dhe plotësimin e nevojave substanciale për arsimin dhe shëndetësinë. Nga njerëzit ka ankesa me muaj nuk mund ta bëjnë testin për Covid - 19, edhe pas daljes së tyre pozitiv, ata duhet ta kenë një trajtim të vazhdueshëm nga shëndetësia jonë primare deri në shërimin e tyre, për këtë punë duhet që Qendra jonë shëndetësore të furnizohet me pajisje adekuate shëndetësore dhe barna. Unë më herët kam qenë kundër projektit të Karitasit, për arsye që i kam sqaruar, atëherë unë kam kërkuar që të forcohet Drejtoria Komunale për Shëndetësi, por tani në këtë kohë më duhet t'i përkrah mjekët dhe infermeret që kanë një pagë të ulët vetëm prej 250.00€ për infermieri dhe 350.00€ për mjekë, që krahasuar me stafin e rregullt mjekësorë është pagë jo dinjitoze, këta persona e kanë bartur barrën e përgjegjësisë në kohën e pandemisë, edhe mjekët që kanë punuar vullnetarë në këtë kohë të pandemisë që nga fillimi, komuna jonë duhet t'i ndihmën me mjete financiare. Kur dezinfektohen shkollat dhe institucionet tjera publike duhet të dezinfektohen edhe xhamitë në komunën tonë, sepse mundësi për këtë punë ka, sepse aty vjen prindi ynë, gjyshi ynë, ne duhet të punojmë drejtë me qëllim të mbrojtjes së popullatës tonë nga përhapja e pandemisë. Unë nuk pajtohem me mendimin e anëtarit të Kuvendit të Komunës nga radhët e komuniteteve z. Suhat Ademi, nuk duhet të kemi ndarja trajtimi i qytetarëve duhet të jetë i barabartë nga burimet financiare të shtetit. Ne kemi informata se komunitetet janë përkrahur shumë në kohën e pandemisë. Tani do të kemi rritjen e qarkullimit në autobus, nxënësit do të vijnë në shkollë nga

fshatrat, kushtet nuk janë më të mirat në transportin tonë. Po ashtu unë e kam një sugjerim që të vendosen kamera nëpër shkolla, të analizohet situata, për një menaxhim më të mirë të gjendjes që mund të krijohet në të ardhmen e afërt.

Driton Ademi: Ne nuk e kemi procesverbalin e takimit të Ekzekutivit të Komunës për të ditur saktë, cilat janë kërkesat e drejtorëve komunal, sidomos të drejtorëve për arsim dhe shëndetësi. Baza e shpërndarjes së mjeteve financiare është Ministria e Financave, nuk ka ndonjë selektim të argumentuar të kërkesave, çka është pranuar dhe çka është refuzuar, përgjegjës për marrjen e vendimit janë përfaqësuesit e Lidhjes Demokratike të Kosovës si parti politike në pushtet, ne këtu vazhdimisht po kërkojmë llogaridhënie, sqarime dhe arsytetime për shpërndarjen e mjeteve financiare dhe shpenzimet, këto sqarime ne nuk po i marrim, andaj nuk po na ofrohet as mundësia që me bindje t'i përkrahim propozimet e Ekzekutivit të Komunës. Unë propozoi që të formohet një Komision për monitorimin dhe mbikëqyrjen e shpenzimit të këtyre mjeteve financiare.

Suhata Ademi: Arsyeja pse ne e kërkojmë një buxhet të veçantë për komunitetet tona është Qendra me pesëqind nxënës, që nuk ka përfituar asgjë, as nga niveli qendror, ka shumë nevojë për mjete elektronike të punës llap-toë dhe I-pad.

Kryesuesja e Kuvendit të Komunës: Probleme të njëjta kanë patur edhe nxënësit shqiptarë, mësimi online ka qenë një përvojë e re dhe sfidë për të gjithë ne, edhe mësimdhënësit, janë përdorë platform sociale, sidomos zoomi, ky nxënësit janë kyqur në mësim.

Sabit Bullatovci: Përrshëndes të pranishmit në mbledhje. Unë kërkoi që të jemi të përgjegjshëm dhe të mos shtyhem si subjekte politike, po thuaj se për asgjë, pandemia është një sfidë për të gjithë neve, e ka kapluar gjithë botën dhe vendin tonë, andaj duhet të jemi të bashkuar në adresimin e punëve tona dhe shpërndarjen e mjeteve financiare në vendin e duhur. Qeveria ka propozuar që të shpenzohen këto mjete financiare, që janë të taksapaguesëve tonë, ekzekutivi ynë lokal ka propozuar shpenzimin në dy shtylla për shëndetësinë dhe ekonominë, ju duhet ta dini se bizneset po mbyllen një pjesë e tyre edhe nuk mund të rihapen, sepse kanë qenë të dobëta, andaj duhet të përkrahen me mjete financiare aq sa kemi mundësi buxhetore. Doktorit e theksoi se me këto mjete mund të bëhen vetëm katër mijë teste, mjekët kanë punuar dhe për arsye të ndryshme administrative nuk janë përkrahur, ata duhet të përkrahen edhe financiarisht, edhe me mjete mbrojtëse cilësore për punë, sepse janë të rrezikuara, duke e mbrojtur shëndetin e popullatës. Ekzekutivi i Komunës duhet të na dëgjon neve, por propozimet tona duhet të jenë të arsyeshme për kohën që po e kalojmë tani.

Mehdi Lahu: Përrshëndes të pranishmit në mbledhje. E theksoi shumë bukur doktorit z. Remzi Shala duhet të blihet aparatura për testimin serologjikë, të banorëve të Komunës së Fushë-Kosovës. Ne nuk kemi informata nga Shtabi Emërgjentë i Komunës, se sa banorë të komunës tonë janë të infektuar me virusin Kovid - 19. Dezinfektimi në fillim është bërë nëpër hyrje të ndërtesave, tani duhet të dezinfektohen shkollat, për arsimin duhet të ndahen mjete financiare shpesh, të krijohen dhoma të ve-qanta për trajtimin e nxënësve, të plotësohen kushtet që kërkohen për mësim në kohën sa do të zgjatë pandemia. Duhet të kërkohet ndihmë nga donatorët dhe Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, komunitetet romë, ashkalinjë dhe egjiptian kanë nevojë më shumë për ndihmë, duhet të sigurohen maskat për nxënës. Bizneset e vogla meritojnë të përkrahen sepse janë dëmtuar shumë në periudhën e kaluar gjashtëmujore, funksionimi i tyre është vështirësuar shumë, sepse kapacitetet e tyre për zhvillim janë minimale. Unë i njoh dy rrobaqepëse që kanë punuar edhe maska për nxënës, andaj ne duhet t'i përkrahim. Ky fond ekonomik është i mirë se ardhur

dhe në kohën e duhur, për të ndihmuar sa do pak bizneset e vogla. Njerëzit me Kovid - 19, duhet të përkrahen me pako ushqimore dhe me barna nga komuna, sepse ata duhet të qëndrojnë të izoluar, andaj familjet e tyre kanë nevojë për ndihmë.

Shaban Ademi: I nderuari anëtar i Kuvendit të Komunës, kjo mbledhje është shumë e qetë dhe ne po japim propozimet tona për adresimin e çështjeve urgjente në këtë momentë dhe unë propozoi që prioritet t'i jipet arsimit dhe t'i ndahet shuma e mjeteve financiare prej: 60,000.00€. **Drejtori për Arsim:** Përshëndes të pranishmit në mbledhje. Unë me bindje të plotë e them se rimëkëmbja ekonomike me këto mjete financiare nuk bëhet, neve në arsim për vitin e ardhshëm na janë tërhequr mbi 1.2 milion euro dhe e kemi shumë vështirë të funksionojmë. Orientimi dhe fokusimi ynë në periudhën e ardhshme, duhet të jetë arsimi dhe shëndetësia, sepse kjo punë po na imponohet detyrimisht edhe nga situata me pandeminë. Unë shqetësimet e mia I kam ngritur edhe në mbledhje me Qeverinë e Kosovës, tani për tani askund nuk jemi, ne nuk duhet të trajtohem me komunat ku numri i nxënësve është për çdo vitë në rënie, komuna jonë dhe komuna e Ferizajit duhet ta ketë një trajtim tjetër, por kjo nuk po ndodh nga niveli qendror, andaj vend tjetër për adresimin e çështjeve tona është Kuvendi i Komunës, kur vendos për ndarjet buxhetore. Me mjetet financiare që i kemi në dispozicion për mallëra dhe shërbime nuk mund të sigurohet, as higjiena, as ngrohja e shkollave, ne e kemi kalkuluar edhe ndarjen e paraleleve, numri po na del nga 22 nxënës po flas për shkollat e qytetit, mësimi duhet të fillon për dhjetë ditë, do të rritet numri i të infektuarëve, unë kam mësues që punojnë gjashtë muaj pa rrogë, situata në shumë aspekte është e rëndë, sepse kemi rritje enorme të numrit të nxënësve në fillimin e secilit vitë shkollorë. Shkolla 'Mihal Grameno' me objektin e ndarë shkollorë është shkolla më e madhe në Kosovë, andaj unë duke i ditur të gjitha këto fakte të gjendjes ekzistuese, kërkoi nga ju që ta përkrahni arsimin në komunën tonë.

Nënkryetari i Komunës: Përshëndes të pranishmit në mbledhje. Me ndarjet buxhetore ne duhet t'i përshtatemi rrethanave të krijuara, arsimi duhet të përkrahet, por me një shumë që nuk i dëmton sektorët tjerë, as sektorin e shëndetësisë dhe as ndihmën ekonomike për bizneset. Nga kodi për ndihma ekonomike të mirret shuma e mjeteve financiare prej 30,000.00€ në disa aspekte tjera, arsimi do të përkrahet edhe nga mjetet e ndara për shëndetësinë dhe shërbimet publike, ku hyn edhe dezinfektimi i shkollave.

Driton Ademi: E para, prap duhet ta përsërisë Drejtoria e Arsimit është dashur ta kërkon përkrahje në Ekzekutivin e Komunës, por si duket këtu ka munguar komunikimi ndërmjet drejtorëve dhe Kryetarit të Komunës. Drejtoria e Arsimit ka obligime financiare edhe për pagesat e mësuesve, që i fitojnë lëndet e tyre me përmbaues privat, po ashtu sfidë në vetë vete, është edhe organizimi i mësimit në fillim të vitit shkollorë dhe mbarëvajtja e tij.

Drejtori për Financa dhe Buxhet: Kjo është mbledhje e jashtëzakonshme, kjo mjete financiare mirren nga kodi i projektit 00099, ne kemi mjete financiare të mjaftueshme për arsimin në kategorinë ekonomike të mallrave dhe shërbimeve, shumta prej 400,000.00€.

Drejtori për Arsim: Ne e kemi patur shumën e mjeteve financiare prej 400,000.00€, por shuma e mjeteve financiare prej 70,000.00€ janë marrë nga përmbauesi privat. Përmbauesi privat nuk pyet fare, ai i merr mjetet financiare edhe në kategorinë ekonomike të mallrave e shërbimeve edhe në projekte kapitale.

Ali Ismaili: Kjo e vë në pah moshë funksionimin edhe të nivelit qendror edhe të nivelit lokal, të ne janë shpenzuar 404,000.00€ në fillim të pandemisë, arsimi nuk është ndihmuar fare me

financiare, as në organizimin e mësimi online, as nxënësit e familjeve me gjendje të rëndë ekonomike dhe sociale nuk janë furnizuar me mjete elektronike të punës - llap-topë. Shkollat duhet ta kenë nga një psikolog dhe personelin mjekësorë që ua matë temperaturën nxënësve, ne pajtohemi që për arsimin të ndahet shuma e mjeteve financiare prej: 30,000.00€ dhe kjo shumë të mirret nga zhvillimi ekonomik.

Drejtori për Arsim: Ne kemi problem me norma për mësimdhënës, edhe në konkursin që është i shpallur tani për 22 mësues, ata nuk mund t'i fusim në sistemin e pagave.

Ali Ismaili: Nëse paraqitet ndonjë problem më i madh, ne mund ta rrisim shumën e mjeteve financiare në 50,000.00€ për arsimin.

Remzi Shala: Ne kërkojmë një pushim prej dhjetë minutave, që të konsultohemi për ndarjen e shumës së mjeteve financiare prej: 50,000.00€, për arsimin.

Migjen Kolshi: Mos komunikimi i Drejtorit të Arsimit me Kryetarin e Komunës është shqetësues, sepse këtu kemi të bëjmë me nxënësit, nuk është ndihmë shumë prej: 2,000.00€ për bizneset që kanë pësuar humbje të mëdha, andaj duhet të përkrahen në këtë fazë arsimit dhe shëndetësia. Kryetari i Komunës i propozon këto shuma për bizneset, për t'i rregulluar raportet me bizneset.

Drejtori për Financa dhe Buxhet: Unë pajtohem me mendimin e anëtarit të Kuvendit të Komunës z. Shaban Ademi që e tha në fillim, për ndarjen e 50,000.00€ për arsimin dhe ato të mirren nga zhvillimi ekonomik.

Nënkryetari i Komunës: Propozimet e anëtarëve të Kuvendit të Komunës z. Remzi dhe z. Shaban janë të përafërta.

Remzi Shala: Ne jemi që të përkrahet propozimi i thënë nga Drejtori për Financa dhe Buxhet për ta ndihmuar arsimin.

Drejtori për Financa dhe Buxhet: Nga pakot ushqimore dhe pakot hixhenike të mirren nga 5,000.00€, nga dezinfektimi të mirren 10,000.00€ dhe nga zhvillimi ekonomik 50,000.00€, këto mjete financiare të destinohen për administratën e arsimit në kategorinë ekonomike të mallërave dhe shërbimeve, kodi për menaxhimin e pandemisë 00099, në mallëra e shërbime me kod 13430.

Aida Alimi: Ne e përkrahim për aprovim propozimin e sqaruar nga Drejtori për Financa dhe Buxhet.

Durim Hajra: Është logjike që nevojat janë të mëdha në Drejtorinë e Shëndetësisë, por nuk ka kordinim, efekti i shpenzimeve duhet të matet, ju jeni duke e ofenduar intelegjencën tonë, me këto propozime. Tani po e bëni analizën se si duhet të përkrahen shëndetësia, arsimit dhe sektori privat.

Jetmir Berisha: Përshëndes të pranishmit në mbledhje. Lidhur me propozimin e Drejtorisë së Financave dhe Buxhetit ne jemi të një qëllimi dhe një mendimi, shëndetësia dhe arsimit janë me prioritet dhe duhet të përkrahen, ne si komunë i kemi 8800 nxënës, andaj për arsimin nevojitet një përkrahje më e madhe, duhet të blihen maska mbrojtëse dhe dezinfektues. Në muajin tetor apo nëntor mund të kemi prap mbyllje, edhe bizneset janë dëmtuar shumë, por shuma që mbetet për ndihmë sektorit privat besoj që është e mjaftueshme. Bizneset tani vetëm po mbijetojnë, patjetër se unë pajtohem që duhet të përkrahet edhe sporti dhe Organizatat Jo Qeveritare.

Driton Ademi: Mjetet financiare nga pakot ushqimore dhe pakot hixhenike duhet të bashkohen, shuma të zvogëlohet dhe të ndahet për arsimin, nga zhvillimi ekonomik të mirret shuma e mjeteve financiare prej: 200,000.00€ dhe ato të ndahen për furnizime mjekësore dhe për arsim.

Nënkryetari i Komunës: Arsimit e ka fondin e vetë për mallëra dhe shërbime, në shkresë shkruan se duhet të përkrahet shëndetësia dhe ekonomia.

Drejtori për Zhvillim Ekonomik: Përshëndes të pranishmit në mbledhje. Ky debat duhet të jetë një mundësi shtesë për ekonominë, e cila është dëmtuar nga pandemia dhe kufizimet e vendosura nga institucionet tona, me këto mjete financiare ne mund t'i përkrahim bizneset me nga 300.00€, arsimi i ka fondet e veta për mallëra dhe shërbime, unë ju ftoi që ta votoni këtë fond për ndihmë ekonomike sektorit privat.

Drejtori për Arsim: Këtu nuk është problem mos kordinimi, por nevoja e madhe për arsimin, sepse kemi shumë vështirësi, për të menaxhuar arsimin me fondet në dispozicion, edhe nëse ndahen këto mjete financiare kjo është vetëm një zgjidhje e përkohshme.

Durim Hajra: Këto pakënaqësi që po paraqiten këtu është dashur të harmonizohen me Drejtorinë e Financave dhe Buxhetit.

Pas sqarimeve, Kryesuesja e Kuvendit të Komunës e qiti në votim 'Propozimin për ridestinimin dhe ndarjen e mjeteve financiare nga buxheti i planifikuar komunal për vitin 2020, me ndarjen e shumës së mjeteve financiare prej: 70,000.00€ për arsimin, ku 50,000.00€ mirren nga zhvillimi ekonomik, 10,000.00€ mirren nga shërbimet publike dhe nga 5,000.00€ prej pakove ushqimore dhe pakove hixhenike dhe sanitare'.

U votua me: njëzet e tre vota 'për', një 'kundër', dhe asnjë abstenim, gjithsej njëzet e katër anëtarë të pranishëm.

Në bazë të votimit, Kryesuesja e Kuvendit të Komunës konstatoi se Kuvendi i Komunës, me shumicë të votave e aprovoi 'Propozimin për ridestinimin dhe ndarjen e mjeteve financiare nga buxheti i planifikuar komunal për vitin 2020, me ndarjen e shumës së mjeteve financiare prej: 70,000.00€ për arsimin, ku 50,000.00€ mirren nga zhvillimi ekonomik, 10,000.00€ mirren nga shërbimet publike dhe nga 5,000.00€ prej pakove ushqimore dhe pakove hixhenike dhe sanitare' dhe mori:


V E N D I M

Për lejimin e shfrytëzimit, ridestinimit dhe shpërndarjes së mjeteve financiare në shumë prej: 748,595.00€, bazuar në shkresën e Ministrisë së Financave Nr. 01/1157, të datës 10.08.2020, ridestinohen dhe transferohen për shpenzim nga kategoria ekonomike e rezervës e planifikuar për vitin 2020, në kategoritë tjera ekonomike për menaxhimin e situatës emergjente në shëndetësi, ekonomi, arsim, shërbime publike dhe kulturë, rini dhe sport.


Kryesuesja e Kuvendit të Komunës falënderoi të pranishmit për pjesëmarrje në mbledhje. Mbledhja përfundoi në ora 12:15 minuta.

Procesmbajtës

Hasan Gjyrevci




Kryesuesja e Kuvendit të Komunës
Vjollea Konjusha





**REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA**

**KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS / OPŠTINA KOSOVO-POLJE
MUNICIPALITY OF FUSHË-KOSOVË, KOSOVO POLJE**



Ekstrakt nga procesverbali i mbledhjes së tetë - VIII-të, të jashtëzakonshme të Kuvendit të Komunës, e mbajtur me datën 01.09.2020, ora 10:00h, në Sallën e Kuvendit të Komunës.

Prezentë në mbledhje ishin anëtarët e Kuvendit të Komunës: Vjollca Konjusha - Kryesuese e Kuvendit të Komunës, Remzi Shala, Ilir Hasani, Arjeta Jashari, Mirvete Gërguri, Jetmir Berisha, Albert Jasharaj, Miranda Shabani, Sabit Bullatovci, Sabri Rexhepi, Ali Zogjani, Doruntina Jashari, Eglantina Azemi, Aida Alimi, Arjana Zogjani, Naser Graçevci, Migjen Kolshi, Driton Ademi, Ali Ismaili, Driton Hasolli, Mehdi Lahu, Shaban Ademi, Mensur Grajqevci, Hysni Hasani, Suhat Ademi dhe Ljubisa Qirkoviq.

Mungon: Durim Hajra.

Kryetari i Komunës dhe Drejtorët e Drejtorive të Komunës: Fadil Krasniqi - Nënkrjetar i Komunës, Ramadan Jashanica - Drejtor i Financave e Buxhetit dhe Ekrem Berjani - Drejtor i Zhvillimit Ekonomik.

Kryesuesja e Kuvendit të Komunës përshëndeti të pranishmit në mbledhje, pas verifikimit të prezencës së anëtarëve të Kuvendit të Komunës, konstatoi se ekziston kuorumi për mbajtjen e mbledhjes dhe prezantoi këtë:

REND DITE

1. Propozim për shfuqizimin e vendimit Nr. 111, të datës 20.08.2020.
2. Propozim për ridestinimin dhe ndarjen e mjeteve financiare nga buxheti i planifikuar komunal për vitin 2020.

Kryesuesja e Kuvendit të Komunës, sqaroi se për shqyrtim në këtë mbledhje të jashtëzakonshme i kemi dy pika të rendit të ditës: Propozimin për shfuqizimin e vendimit Nr. 111, të datës 20.08.2020 dhe Propozimin për ridestinimin dhe ndarjen e mjeteve financiare nga buxheti i planifikuar komunal për vitin 2020'. Hap diskutimin.

U votua me: nëntëmbëdhjetë vota 'për', asnjë 'kundër' dhe një abstenim, gjithsej njëzet anëtarë të pranishëm.

Në bazë të votimit, Kryesuesja e Kuvendit të Komunës konstatoi se Kuvendi i Komunës, me shumicë të votive e aprovoi rendin e ditës.

Pika e parë (1) - Propozim për shfuqizimin e vendimit Nr. 111, të datës 20.08.2020.

Kryesuesja e Kuvendit të Komunës: E kemi shkresën e Ministrisë së Financave, që sqaron se shuma e mjeteve financiare për shpenzim është më e vogël për 49,000.00€, tani për shpenzim mbeten vetëm 699,140.00€, andaj vendimi Nr. 111, i datës 20.08.2020 duhet të shfuqizohet.

Pas sqarimeve, Kryesuesja e Kuvendit të Komunës e qiti në votim 'Propozimin për shfuqizimin e vendimit Nr. 111, të datës 20.08.2020'.

U votua unanimisht nga të pranishmit, gjithsej njëzet anëtarë të pranishëm.

Në bazë të votimit, Kryesuesja e Kuvendit të Komunës konstatoi se Kuvendi i Komunës, me unanimitet të votave e aprovoi 'Propozimin për shfuqizimin e vendimit Nr. 111, të datës 20.08.2020' dhe mori:

V E N D I M

Për shfuqizimin e vendimit Nr. 111, të datës 20.08.2020, sipas shkresës së Divizionit për Buxhetet e Komunave të Ministrisë së Financave të datës 21.08.2020, për lejimin e destinimit dhe shpërndarjen e mjeteve financiare në buxhetin e vitit 2020 sipas shkresës së Nr. 01/1157, të datës 10.08.2020.

Pika e dytë (2) - Propozim për ridestinimin dhe ndarjen e mjeteve financiare nga buxheti i planifikuar komunal për vitin 2020.

Kryesuesja e Kuvendit të Komunës: E kemi për shqyrtim 'Propozimin për ridestinimin dhe ndarjen e mjeteve financiare nga buxheti i planifikuar komunal për vitin 2020', ku tani mjetet financiare do të shpërndahen për arsimin, shëndetësinë dhe zhvillimin ekonomik, ftoi Drejtorin e Financave dhe Buxhetit që të na jap sqarime.

Drejtori për Financa dhe Buxhet: Përshëndes të pranishmit në mbledhje. Të nderuarë ju para vetës e keni shkresën e Ministrisë së Financave, ku tani shuma e përgjithshme e mjeteve financiare e lejuar për shpenzim është 699,140.00€, ku kemi disa ndryshime në shpenzime, që duhet t'i ruajmë fondin e mjeteve financiare për shpenzim në arsim në shumë prej: 256,818.00€, po ashtu në kuadër të dezinfektimit hyn edhe dezinfektimi i hapësirave në territorin e komunës tonë. Të gjitha të dhënat dhe shifrat për shpenzim nëpër kode ekonomike i keni në propozim.

Remzi Shala: Ne Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Kosovës, e kemi shqyrtuar dhe analizuar propozimin e Drejtorisë së Financave dhe Buxhetit dhe pajtohemi me propozimin në fjalë, meqë me shuma të konsiderueshme përkrahen arsimi dhe shëndetësia, kemi kërkuar që të përfshihet edhe dezinfektimi, kjo është pranuar dhe ne pajtohemi që propozimi për ridestinimin dhe shpërndarjen e mjeteve financiare të aprovohet.

Migjen Kolshi: Përshëndes të pranishmit në mbledhje. Unë dua të bëjë këtu një reagim ndaj partisë së opozitës Nismës Socialdemokrate dhe një shkrimi të përfaqësuesit të saj z. Driton Ademi, ku ka thënë se opozita është e shthurur duke shpërndarë dezinformata në media, ajo është vetëm një ide e juaja dhe nuk e përfaqëson opozitën e Kuvendit të Komunës, për secilin propozim ne i japim vlerësimet tona, por pozita i ka numrat e mjaftueshëm dhe i kalon propozimet e saj, andaj ju jeni vetëm një person dhe nuk keni të drejtë të flisni në emërin e të gjithë neve. Dezinfektimi në Komunën e Fushë-Kosovës nuk është bërë as vitin e kaluar për arsye se Kryetari i Komunës dhe drejtorët kanë bletë, unë kam hulumtur dhe kjo kushton 40,000.00€, është e ulët që kjo punë në interesin e qytetarëve të mos bëhet për këtë arsye.

Driton Ademi: Përshëndes të pranishmit në mbledhje. Unë i kam dhënë vërejtjet e mia për ridestinimin e mjeteve financiare dhe kam thënë, se shumë iniciativa të mia në Kuvendin e Komunës nuk janë përkrahur. Këtë vitë projekti i tri DDD nuk ka ndodhur fare, për arsye që dihen, kjo është shumë e vërejtur sidomos në fshatin Henc, për shkak të liqenit, aty janë shumë barishta dhe ka numër të madh të mushkonjave, që janë edhe burim për infeksione të ndryshme. Të vijmë çështjet e planifikimit të buxhetit çdo dy muaj me ndryshime kjo nuk është në rregull dhe paraqet një keqë-planifikim të buxhetit, nga ana e Ekzekutivit të Komunës. Politikat fiskale për

shpërndarjen e mjeteve financiare nuk duhet të dalin prej zarfave 'ad hoc' por aty duhet të jenë të planifikuara mirë.

Naser Graiçevci: Përshëndes të pranishmit në mbledhje. Ne duhet të mendojmë në aspektin praktikë për shpenzimin e buxhetit, meqë jemi në kohën e pandemisë, unë vetë me familjen time e kam kaluar këtë virus, ku trajtimi dhe shërimi kushton 600-1000 euro për person, që për familjet e varfëra është mjaft e vështirë të përballohet, jamë kontaktuar vetëm nga Qendra emërgjente shëndetësore, por jo edhe nga Shtabi Emërgjentë i Komunës që duhet të jetë në funksion të qytetarëve. Në Qendrën Kryesore të Mjekësisë Familjare në Fushë-Kosovë mungojnë barnat, mungojnë gjërat esenciale për të i'u dalur në ndihmë pacientëve, barnat duhet të blihen dhe këtyre familjeve të i'u sigurohen 50% të barnave, ose ato të jipen falas, mundësi financiare për këtë punë komuna jonë ka. Ndihma ekonomike për bizneset duhet të jetë transparente me mundësi të barabarta, për të gjitha bizneset e komunës tonë, të caktohen kritere për këtë çështje, e jo të punohet aty për aty.

Mehdi Lahu: Përshëndes të pranishmit në mbledhje. Lidhur me atë që e ceku parafolësi im, ne si komunë duhet të orientohemi në kryerjen e testeve serologjike. Duhet të furnizohet Qendra shëndetësore me barna sepse janë tri terapi që duhet t'i marrin pacientët e prekur me virusin Kovid - 19. Edhe për Drejtorinë e Arsimit duhet të gjinden fonde të mjaftueshme, për përgatitjen e fillimit me sukses të vitit të ri shkollorë, unë mendoj se arsimi dhe shëndetësi duhet të përkrahen.

Remzi Shala: Barna sa i përket kujdesit parësorë shëndetësorë ka dhe ato u jipen pacientëve, ne i kontaktojmë pacientët e prekur me virusin Kovid - 19, është ekipi i veçantë që mirret me përcjelljen e gjendjes shëndetësore të pacientëve. Kushtimi real dhe barnat që duhet t'i marrë një pacientë janë 200-300 euro për person, ne nuk mund të ndërhyjmë në punën që i takon kujdesit sekondarë dhe terciarë shëndetësorë. Ne duhet të blejmë aparaturën për kryerjen e testeve serologjike, për t'i'u dalur në ndihmë qytetarëve të komunës tonë.

Ali Ismaili: Përshëndes të pranishmit në mbledhje. Debati për këtë q-ështje është shterrur para një jave kur e kemi bërë ndarjen e mjeteve financiare, ne mjete financiare të mjaftueshme kemi ndërë edhe në fazën e parë të pandemisë, në fillim ka patur shumë vështirësi dhe mungesë të barnave. Tani mësimi është shtyerë për dy javë dhe kjo kohë duhet të përdoret për dezinfektimin e objekteve shkollore, sigurimin e maskave mbrojtëse për mësuesit dhe nxënësit. Unë mendoj se të paguhet një asambleistë sa një portirë, kjo punë nuk don komentë, por ligji është anuluar dhe jemi në këtë gjendje. Unë kërkoi që të kemi një transparencë në shpërndarjen e këtyre mjeteve financiare, sepse janë 700,000.00€ dhe 400,000.00€ në mujin mars, pra janë mbi 1.1 milion euro, duhet të jipet llogari për mjetet e shpenzuara financiare. Ka informata se pakot ushqimore dhe hixhenike të shpërndara për qytetarë kanë qenë në vlerë prej 15€, aty nuk ka asgjë, nuk ka furnizim as për një javë. Lidhur me gjendjen e të infektuarëve me Kovid - 19 ne duhet të informohemi në çdo mbledhje nga përfaqësuesi i Shtabit Emërgjentë Komunal. Sa i përket ekonomisë, shumë biznese janë në prag të falimentimit, andaj kjo ndihmë ekonomike mendojmë se do t'i ndihmon pak në tejkalimin e vështirësive të tyre. Ne kërkojmë që të dezinfektohen edhe objektet fetare, xhamitë tona, sepse aty janë njerëzit tonë, gjyshërit tonë.

Remzi Shala: Deri me datën 31.08.2020 janë 590 persona të infektuar, 379 janë të shëruar, 196 raste aktive dhe 15 persona kanë ndërruar jetë.

Pati edhe diskutime dhe sqarime tjera pas të cilave Kryesuesja e Kuvendit të Komunës e qiti në votim 'Propozimin për ridestinimin dhe ndarjen e mjeteve financiare nga buxheti i planifikuar komunal për vitin 2020'.

U votua me: tetëmbëdhjetë vota 'për', një 'kundër', dhe katër abstenime, gjithsej njëzet e tre anëtarë të pranishëm.

Në bazë të votimit, Kryesuesja e Kuvendit të Komunës konstatoi se Kuvendi i Komunës, me shumicë të votave e aprovoi 'Propozimin për ridestinimin dhe ndarjen e mjeteve financiare nga buxheti i planifikuar komunal për vitin 2020' dhe mori:


V E N D I M

1. Për lejimin e shfrytëzimit, ridestinimit dhe shpërndarjes së mjeteve financiare në shumë prej: 699,140.00€, bazuar në shkresën e Ministrisë së Financave Nr. 01/1157, të datës 10.08.2020 dhe shkresat e datës 21.08.2020 dhe 31.08.2020, ridestinohe dhe transferohen për shpenzim nga kategoria ekonomike e rezervës e planifikuar për vitin 2020, në kategoritë tjera ekonomike për menaxhimin e situatës emergjente në shëndetësi, ekonomi, arsim dhe plotësimin e prioritetëve dhe nevojave tjera komunale si vijon:
 - 1.1 Në shëndetësi transferohet shuma e mjeteve financiare prej: 133,636.00€;
 - 1.2 Në Zhvillim Ekonomik transferohet shuma e mjeteve financiare prej: 308,686.00€ dhe
 - 1.3 Në Administratën e Arsimit transferohet shuma e mjeteve financiare prej: 256,818.00€.

Kryesuesja e Kuvendit të Komunës falënderoi të pranishmit për pjesëmarrje në mbledhje. Mbledhja përfundoi në ora 10:50 minuta.

Procesmbajtës

Hasan Gjyrevci



Kryesuesja e Kuvendit të Komunës

Vjollca Konjusha

